

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË KRUIJË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Krujë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 185, datë 29.12.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 985/8, datë 29.12.2014, i ka rekomanduar z. Shkëlzen Hoxha, Kryetar i Bashkisë Krujë, zbatimin e masave të mëposhtme:

MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje: Nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna më parë nga KLSH, e konkretisht: 6 masa organizative, masa për shpërblim dëmi për vlerën 3,127,861 lekë, 2 masa administrative për vlerën 100,000 lekë, për 2 mbikëqyrësit (*gjobë me nga 50,000 leke secili*), me mundësi arkëtimi, pasi një mbikëqyrës ka pasur marrëdhënie pune kontraktore me Bashkinë në vitin 2014.

Rekomandimi: Bashkia Krujë, të marrë masa për zbatimin rekomandimeve të lëna më parë nga KLSH, duke zbatuar të gjitha procedurat administrative dhe ligjore si dhe të kryhen të gjithë hapat në shkallët gjyqësore, konkretisht: vlerën **3,127,861 lekë** nga “*A..i 2..*” shpk për 1,677,661 lekë, “*K..i & C..i*” shpk, për 868,000 lekë dhe “*V..a & A...a K...n*” shpk, për 582,200 lekë, dhe vlerën **50,000 lekë gjobë** për zj.D.Q. dhe z.R.Ll. **50,000 lekë**.

Brenda datës 28.02.2015

2. Gjetje: Nuk janë zbatuar procedurat e përzgjedhjes së punonjësve të policisë bashkiake, pasi nuk kanë arsimin përkatës të përfunduar në akademinë e rendit, nuk kanë funksionuar në komisione të posaçme dhe nuk ka kontrata 3-vjeçare, sipas kriterëve të Rregullores Brendshme "TIP" të Policisë të Bashkisë, të miratuar me Urdhrin e Përbashkët të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit dhe Ministrit të Rendit, nr. 1, datë 17.04.2003, neni 11 dhe 7, “*Përzgjedhja e kandidatëve, formimi dhe kualifikimi*” pikat 2 dhe 5, me nenin 4, të ligjit nr. 8224, datë 15.5.1997, “*Për Organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë*”, i ndryshuar me ligjin nr. 8335, datë 23.04.1998.

Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa për emërimin e punonjësve të policisë me komision të posaçëm dhe të vendoset kriter që konkurrentët të kenë mbaruar Akademinë e Rendit dhe më tej të lidhen kontratat 3-vjeçare.

Brenda datës 28.02.2015

3. Gjetje: Nuk janë zbatuar kriteret për emërimin e punonjësve të INUV, pasi emërimi i tyre është kryer në kushtet e mungesës së arsimit profesional, në kundërshtim me nenin 11, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar me ligjin 10240, datë 25.02.2010, nr. 10323, datë 23.9.2010, “*Për Inspektoriatin e Ndërtimit*”.

INUV nuk ka vendosur gjoba, ka kryer pjesërisht prishje dhe nuk ka bërë asnjë kallëzim penal, për rastet e ndërtimeve të paligjshme në fushën e ndërtimit dhe planifikimit territorit, veprime këto në kundërshtim me pikën 8, të VKM nr. 862, datë 05.12.2007 “*Për unifikimin e*

procedurave të kontrollit të territorit nga INUK dhe INUV”, me nenin 5/b e d të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për Inspektimin e ndërtimit”.

INUV nuk ka bashkëpunuar me strukturat policore, për prishjen dhe lirim të hapësirave publike nga ndërtimet e paligjshme, shembjen e mureve, shkallëve në trotuare, lirim të oborrit brenda dhe jashtë muzeut Kombëtar “Skënderbeu” etj (*pavarësisht se shumica e këtyre ndërtimeve u përkasin viteve para periudhës së auditimit*), veprime këto në kundërshtim me kërkesat e nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për Inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar.

INUV nuk ka inventarizuar e arshivuar dosjet, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Rekomandimi: Bashkia Krujë, të marrë masa për caktimin e K/inspektorit të INUV, si dhe të emërojë inspektorët në përputhje me kriteret ligjore. INUV të ndjekë në vazhdimësi kontrollin e territorit, me synim mos lejimin e ndërtimeve pa leje, duke vendosur sanksione me gjoba, prishje objektesh dhe kallëzime penale, për të gjitha rastet e ndërtimeve të paligjshme në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës.

Brenda datës 30.01.2015

4.Gjetje: Zyra e taksave vendore ka planifikuar disa nga taksat vendore me rezerva, nuk ka marrë masa për regjistrimin e 31 subjekteve si dhe nuk ka marrë masa për vjeljen e debitorëve të taksave vendore për vlerën 10 milion lekë, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, Udhëzimin e MF dhe MB nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe me nenin 42 të Rregullores së brendshme të bashkisë.

Rekomandimi: Zyra e Taksave të marrë masa:

-për arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara deri më datën 30.9.2014 për vlerën **10 milion lekë** për 116 subjekte debitorë, sipas listës në Aneksin nr. 2 ngjitur raportit përfundimtar.

-për regjistrimin e **31 subjekteve që ushtrojnë aktivitet të pa licencuar**, në të kundërt të zbatohen procedurat tatimore për mbylljen e veprimtarisë në rast mos arkëtimi nga ana e tyre, të detyrimeve që do tu llogariten, sipas listës emërore të pasqyruara në raportin përfundimtar.

-për aplikimin e **taksës të ndërtesës** familjare dhe biznesit të vogël, të bashkëpunohet me ZRPP Krujë ose të bëjë verifikimet në vend me grup pune, për sipërfaqet e banesave dhe ambienteve ku ushtrohet aktiviteti biznesi, për efekt të llogaritjes saktë të saj.

-për planifikimin dhe vjeljen e taksës parkimit për vitin 2014, pasi u konstatuan **936,000 lekë të ardhura të munguara**.

-për planifikimin e taksës tregut dhe hapësirës publike sipas një analize të saktë bazuar në sipërfaqet e zëna dhe numrin e tregtareve. Të kryhet inspektimi i përditshëm i tregut për mbledhjen e taksave ditore dhe mujore.

-për administrimin e taksës therjes bagëtive, taksës të tregut si dhe taksës parkimit automjeteve, të përdoren bileta duke caktuar agjentin tatimor përkatës.

Brenda datës 30.01.2015

5.Gjetje: Buxhetet e viteve 2012, 2013,2014, janë programuar të disbalancuar, në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 12. Në programimin e buxhetit të vitit 2012, nuk janë përfshirë detyrimet afat shkurtër ndaj të tretëve të rezultuara nga mbyllja e vitit 2011 për 41,643 mijë lekë. Në programimin e shpenzimeve për vitin 2013, nuk janë përfshirë detyrimet afat shkurtër ndaj të tretëve të rezultuara nga mbyllja e vitit 2012, në shumën 17,740 mijë lekë. Në programimin e shpenzimeve për vitin 2014, nuk janë përfshirë detyrimet afat shkurtër ndaj të tretëve, të rezultuara nga mbyllja e vitit 2013, në shumën 114,181 mijë lekë.

Rekomandim: Nga Bashkia Krujë, të merren masa përgatitore, për përfshirjen në programimin e buxhetit të vitit 2015, të detyrimeve të prapambetura (faturave të pa likuiduara) që do të rezultojnë në mbyllje të vitit ushtrimor 2014.

Brenda datës 30.01.2015

6.Gjetje: Nga verifikimi i saktësisë në bilancin kontabël nuk është plotësuar libri i llogarisë apo centralizatori, sipas kërkesave të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3, pika 1 dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, pjesa e parë, “Rregulla të përgjithshme”, kapitulli i parë, “Mbajtja e kontabilitetit”. Nga Sektori Ekonomik, nuk është azhurnuar ditari i veprimeve të ndryshme dhe nuk janë azhurnuar në kontabilitet artikujt kontabël të mbylljeve të llogarive në fund të viteve ushtrimore.

Rekomandim: Sektori Ekonomik të marrë masa për të çelur ditarin e veprimeve të ndryshme, centralizatorin për përmbledhjen e të gjitha artikujve kontabël sipas ditarëve të kontabilitetit.

Brenda datës 30.01.2015

7.Gjetje: Nga verifikimi i bilancit, rezultoi se teprica e llogarisë 31 “*Materiale*”, për 3 vite radhazi, është paraqitur me të njëjtën vlerë prej *12,138,388 lekë* dhe nuk janë marrë në konsideratë hyrjet dhe daljet (*kontabilizimet*) sipas ditarit të magazinës.

Nga azhurnimi i veprimeve kontabël të nxjerra nga ditari i magazinës rezultoi se:

-Teprica e paraqitur në bilancin e vitit 2012, është më e madhe se të dhënat e kontabilitetit me vlerë *1,157,425 lekë*, ndërsa teprica e paraqitur në bilancin e vitit 2013 duke e mbartur dhe gabimin e vitit 2012 është në vlerën *2,342,102 lekë*, e cila duhet të sistemohet në bilancin e vitit 2014.

-Llogaria 32, “*Objekte inventari*” pasqyron më tepër në bilanc se kontabiliteti për vlerën *1,732,276 lekë*.

-Llogaria 409, “*Furnitor (debitor) parapagime pagesa pjesore*” është paraqitur në bilancin e vitit 2013 për vlerën *101,290,477 lekë*. Kjo tepricë e kësaj llogarie është vendosur ekstra kontabël (*pa artikull kontabël*) dhe në fakt nga ana e Bashkisë nuk ka asnjë parapagim.

-Sektori Ekonomik nuk ka azhurnuar ditarin e veprimeve të ndryshme dhe nuk ka azhurnuar në kontabilitet artikujt kontabël të mbylljeve të llogarive në fund të viteve ushtrimore.

- Llogaria e debitorëve nuk është mbajtur e analizuar me persona, pasi në asnjë rast nuk është kredituar për shlyerjet nga debitorët me origjinë nga taksat dhe tarifatat, por gabimisht është kredituar llogaria e të ardhurave, kur duhej të kreditohet llogaria e debitorëve. Teprica e llogarisë nr. 468, “*Debitorë në persona*” në bilancin e vitit 2013 paraqitet për vlerën *16,092,052 lekë*,

Veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” neni 3, pika 1, dhe VKM nr. 783 datë, 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, pjesa e parë, “Rregulla të përgjithshme”, kapitulli i parë, “Mbajtja e kontabilitetit”.

Rekomandim: Nga Sektori Ekonomik të merren masa për sistemimin e llogarisë 31 “*Materiale*” për vlerën *2,342,102 lekë*, për sistemimin e llogarisë 32, “*Objekte inventari*” për vlerën *1,732,276 lekë*, për sistemimin e llogarisë 409, “*Furnitor(debitor) parapagime pagesa pjesore*” për vlerën *101,290,447 lekë*, për sistemimin e llogarisë 468 “*Debitorë në persona*” duke azhurnuar të gjitha rastet e shlyerjeve, për të pakësuar tepricën e kësaj llogarie, me analizë sipas personave.

Brenda datës 30.01.2015

8.Gjetje: Nga Bashkia Krujë nuk është ngritur zyrë për administrimin e aseteve siç përcaktohet në VKM nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe

transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” pika 9. Administrimi i pronave nuk është përfshirë në rregulloren e brendshme. Nuk është dhënë asnjë objekt me qira edhe pse janë kaluar në pronësi të Bashkisë me vendime të posaçme të Këshillit të Ministrave gjithsejtë 468 prona. Nga pronat e Bashkisë ka ndërtesa që përdoren nga të tretët, përkatësisht ndërtesa e ish-Komitetit Ekzekutiv 3 kat me sipërfaqe 220 m², ndërtesa e ish-Komitetit të partisë 2 kat me sipërfaqe 220 m² etj.

Nuk është kryer asnjë veprim dhe mungojnë rakordimet me ZVRPP, Krujë dhe ALUIZNI-n, nga Bashkia dhe Sektori i Mbrojtjes e Menaxhimit Tokës të Pyjeve e Strehimit, në sipërfaqet e pyjeve, tokave të pafrytshme dhe pemëtoreve, pasi janë konstatuar ndërtime pa leje në 19 raste, me sipërfaqe 2,435 m², nga të cilat: në qytetin Krujë në 12 raste me sipërfaqe 1515 m², në fshatin Picrrage në 6 raste me sipërfaqe 800 m² dhe në 1 rast me sipërfaqe pemëtore 120 m².

Rekomandim: Bashkia Krujë të marrë masa për administrimin e regjistrimin e pronave në ZVRPP dhe dhënien me qira të tyre në funksion të rritjes të ardhurave. Për rastet e zënieve forcërisht të ndërtesave, të bashkëpunohet me organet e rendit dhe të veprohet sipas procedurave ligjore për lirimin e tyre. Të merren masa për evidentimin e ndërtimeve informale dhe të bashkëveprohet me ALUIZNI e të ndërhyhet me INUK.

Brenda datës 30.01.2015

9.Gjetje: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, rezulton se nga ana e Bashkisë Krujë, pavarësisht ndërmarrjes së nismës për hartimin e planit të përgjithshëm vendor, nuk është hartuar plani i detajuar vendor, kërkesë e VKM nr. 502, datë 13.7.2011, neni 32, “Detyrimi për hartimin e një plani të detajuar vendor”.

Rekomandimi: Bashkia Krujë të marrë masa dhe të fillojë punën për hartimin e planit të detajuar vendor sipas kërkesave ligjore.

Menjëherë.

10.Gjetje: Nga auditimi rezultoi se nuk ka shkresë nga ana e NA të njësisë, për delegimin e rolit të koordinatorit të riskut tek një nëpunës tjetër i nivelit menaxherial. Nuk janë përcaktuar përgjegjësitë e personave që do të merren me menaxhimin e riskut, pavarësisht se sipas përcaktimeve në ligj kjo është detyrë e vetë NA, në zbatim të ligjit nr. 10269, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, nga Drejtorët e Përgjithshëm nuk është formuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), nga ana e stafit të lartë, të mesëm dhe të ulët menaxherial, nuk janë kryer trajnime të mjaftueshme, për njohjen e tyre me kërkesat e ligjit, njohjen me procesin e evidentimit dhe menaxhimit dhe monitorimit të riskut, në këtë institucion nuk ka Kod të Brendshëm Etik, ku të jenë inkuadruar parimet bazë të etikës.

Rekomandimi: Nga NA, të përcaktohen përgjegjësitë e personave që do të merren me menaxhimin e riskut, të krijohet GMS, të merren masa që të kryhen trajnime të stafit, mbi njohjen dhe procesin e implementimit të MFK-së, të merren masa për hartimin dhe miratimin e një Kodi të Brendshëm Etik.

Menjëherë

11.Gjetje: Sektori i Burimeve Njerëzore, nuk ka lidhur kontrata të rregullta me nëpunësit e administratës për 30 raste dhe dokumentacioni i dosjeve është me mangësi, në kundërshtim me nenet 12, 21 dhe 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Për Kodin e Punës”, ndryshuar, me VKM nr. 117, datë 05.03.2014, “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të Personelit e të regjistrit qendror të personelit”.

Rekomandim: Bashkia Krujë, të marrë masa dhe të plotësojë të gjitha dosjet e personelit me dokumentacionin e nevojshëm të përcaktuar në Aneksin I dhe II, dhe të lidhen kontratat si dhe të përmirësohet i gjithë dokumentacioni në dosjet e nëpunësve. Të lidhen kontratat individuale me punonjësit e Bashkisë, ku të parashikohen edhe llojet e masave disiplinore.

Brenda datës 28.02.2015

12.Gjetje: Rekrutimi në punë i punonjësve të Bashkisë Krujë, sipas rastit është bërë me urdhër të Kryetarit të Bashkisë, ose me vendime të Këshillit Bashkiak, pa u kryer procedurat e procesit të konkurrimit, siç përcaktohet në nenin 13 “Pranimi” të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 i ndryshuar me ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”.

Rekomandimi: Bashkisë Krujë të marrë masa, që rekrutimi në punë i nëpunësve të kryhet duke zbatuar procedurat ligjore të konkurrimit.

Në vijimësi.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme ligjore dhe administrative në të gjitha shkallët e gjykimit e ato përmbartimor, me qëllim arkëtimin e vlerës **1,993,500 lekë** nga këto: **507,300 lekë dëm ekonomik** dhe **1,486,200 lekë mungesë të ardhurash**, konkretisht:

1. Gjetje: Është konstatuar se është kryer pagesa në vlerën 507,300 lekë, për punime të pakryera, përfituar nga sipërmarrësi “P..A-X” shpk, për objektin “Rikonstruksionin e rrugës lagjja Pengile”, në kundërshtim me kontratën nr. 877, datë 9.10.2012 dhe preventivin e paraqitur në tender.

Rekomandimi: Të merren masa e të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës **507,300 lekë**, për punime të pakryera, përfituar nga sipërmarrësi “P..A-X” shpk, për objektin “Rikonstruksionin e rrugës në lagjen Pengile”.

Brenda datës 30.01. 2015

2.Gjetje: Nga zyra e taksave vendore nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës 1,486,200 lekë, respektivisht:

-nuk është arkëtuar vlera 1,200,000 leke mungesë të ardhurash, për qiratë e 2 antenave të papaguara për vitin 2012, përkatësisht; SHA “A..C” për 600,000 lekë dhe SHA “V..N” 600,000 lekë, në kundërshtim me kontratat përkatëse dhe VKB nr. 3/1, date 16.5.2012 ”Për miratimin e paketës fiskale”,

-nuk është arkëtuar vlera 286,200 lekë të ardhura të munguara, për taksën familjare të vitit 2012, 2013 dhe 2014, për 116 punonjës të administratës së bashkisë dhe 17 këshilltare, ndërsa që kanë pasur mundësi arkëtimi nëpërmjet pagesave të pagës.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore” dhe me nenin 42 të Rregullores së brendshme të bashkisë.

Rekomandimi: Të arkëtohet vlera **1,486,200 lekë mungesë të ardhurash**, përkatësisht:

-vlera **1,200,000 leke**, për qira të antenave të papaguara për vitin 2012, nga SHA “A..C” për 600,000 lekë dhe SHA “V..N” 600,000 lekë, në kundërshtim me kontratat përkatëse dhe VKB nr. 3/1, datë 16.5.2012 ”Për miratimin e paketës fiskale”, në të kundërt Bashkia të heqë antenat nga territori i saj.

-vlera **286,200 lekë**, për taksën familjare të papaguar për vitin 2012, 2013 dhe 2014, nga 116 punonjës të administratës së bashkisë dhe 17 këshilltar bashkiak, duke bërë ndalesën për secilin në borderotë përkatëse.

Brenda datës 30.01. 2015

D. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në nenin 58 gërma ç, c, b, a “*llojet e masave disiplinore*” të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, në VKM nr. 115, datë 05.03.2014, “*Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil*”, si dhe nenit 12 të kontratave individuale të punës, në nenin 44, të ligjit nr. 8652, datë 31/7/2000 “*Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore*”, **kërkojmë** kryetarit të Bashkisë Krujë, dhënien e masave disiplinore, për punonjësit:

“Largim nga shërbimi civil”, për:

1. L.P. me detyrë drejtoreshë e Planifikimit Territorit (Urbanistikës) dhe në cilësinë e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos anulimin e dy tenderave, pasi në faqen e internetit nuk është hedhur siç duhet preventivi i tenderit dhe në procesverbale nuk ka asnjë gjurmë të korigjimit të gabimit aritmetik, në kundërshtim me Udhëzimin e APP-së. Në këto procesverbale nuk jepet asnjë e dhënë mbi operatorët ekonomikë që janë paraqitur në garë si bashkim i përkohshëm i tyre si dhe nuk ka gjurmë mbi dokumentet që janë paraqitur nga çdo pjesëmarrës në garë. Në një rast ka zbatuar rekomandimin e gabuar të Avokatit të Prokurimeve, i cili është në kundërshtim me aktet ligjore të LPP-së dhe kritereve të veçanta për kualifikim, pasi mbetet vetëm një ofertë e vlefshme, ka kualifikuar në dy raste operatorë ekonomikë në mënyrë të gabuar, por që nuk kanë ndikuar në kualifikim.

-për dhënien e 1 leje ndërtimi (zhvillimi) datë 26.6.2012, për ndërtimin e objektit: Godine banimi dhe shërbimi 1kat dhe 2 kat, ne pjesën veri-perëndimore të kalasë, pa leje të Institutit Monumenteve Kulturës Tiranë dhe pa respektuar distancën e ndërtimit të objektit nga kufiri i zonës mbrojtur, muzeu i heroit kombëtar Skënderbeut, pasi rreth 50 % e objektit shtrihet deri në afërsi të murit kalasë, në kundërshtim me VKM nr. 502, datë 13.07.2011, të ndryshuar, shtojca 2, seksioni 8 si dhe me ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 “*Për Trashëgueshmërinë kulturore*” i ndryshuar, neni 28/3 , 29/2, 32/2 pika 1 e 2, 34, 38 dhe neni 47.

-për objektet për të cilat janë dhënë leje zhvillimi nga ana e zbatuesve të punimeve, nuk është njoftuar në çdo rast zyrtarisht Sektori i Planifikimit të Territorit në Bashki, përpara fillimit të punimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 8402 datë 10.09.1998 “*Për Kontrollin dhe Disiplinimin e punimeve*”, neni 9.

-për dhënie e 4 lejeve të shfrytëzimit, në mospërputhje të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, “*Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit*”, neni 11.

“Pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në 2 vjet”, për:

2. R.S. me detyrë përgjegjëse e degës financës dhe në cilësinë e njësisë së hartimit të Dokumenteve të tenderit, për shkeljet e mëposhtme:

-për pozicione financiare të llogarive në mënyrë të gabuar , përkatësisht: për llogarinë 31 “*Materiale*” për vlerën 2,342,102 lekë në llogarinë. 32, “*Objekte inventari*” për vlerën 1,732,276 lekë, në llogarinë 409 “*Furnitor(debitor) parapagime e pagesa pjesore*” për 101,290,447 lekë.

-për mos mbajtje në mënyrë të analizuar me persona Llogaria e debitorëve, pasi në asnjë rast nuk është kredituar për shlyerjet nga debitorët me origjinë nga taksat dhe tarifat, por gabimisht është kredituar llogaria e të ardhurave, kur duhej të kreditohej llogaria e debitorëve.

-për hedhje të gabuar në sistem të preventivit të punimeve, në dy raste me marrjen e ankesave nga operatorët ekonomikë, nuk ka ndërprerë procedurën e prokurimit, vendosje në disa raste të kërkesave për kualifikim në kundërshtim me DST, vendosje në dy raste të paargumentuar të kritereve për kualifikim, në një rast tenderi me objekt: “Sistemimi i kapitazhit të ujësllësit Sakarrac - Krujë” me “procedurë me negocim pa shpallje paraprake të botimit të kontratës”, nuk ka asnjë të dhënë mbi kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit si dhe ftesat për ofertë nuk janë hartuar sipas kërkesës së LPP, për procedurën e tenderit me objekt: “Sistemim-gjelbërim i zonës së banimit në Deredë, Krujë” specifikimet teknike (preventivi), nuk janë analitike, ato japin të dhëna në total. Në dy raste për përcaktimin e kritereve të veçanta për kapacitetin teknik, nuk ka asnjë të dhënë se si është përcaktuar numri i punonjësve që duhet për të kryer këtë punë, përcaktimi i makinerive, të cilat janë bërë pjesë e DT, në një rast nuk është respektuar me një ditë afati i publikimit nga data e hapjes së tenderit, të publikuar në faqen e internetit të APP-së, për rrjedhje të bllokimit të sistemit nga mosrespektimi i këtij afati. Në një rast nuk ka bërë në mënyrë të qartë modifikimin e dokumenteve të tenderit.

-për tejkallim të limitit të blerjeve me vlera të vogla, për blerje ushqimesh për kopshtet e çerdhet dhe për blerje dru zjarri, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për blerjet me vlera të vogla”, i ndryshuar, trajtuar më hollësisht në faqet 32-40 të raportit të auditimit.

3. A.P. me detyrë Përgjegjëse e KF “Kastrioti” Krujë, për shkeljet e mëposhtme:

- për mos plotësim të librit të llogarisë ose centralizatorit,

-për mos plotësimin e ditarit të bankës dhe mos debitimin dhe kreditimin e llogarisë 520 “Disponibilitet në thesar”, por është mjaftuar vetëm me ditarin e shpenzimeve sipas artikujve,

-për plotësim ekstra kontabël të kontabilitetit dhe tepricave të llogarive të bilanceve,

-për mos sistemimin e llogarisë nr. 468, “Debitorë në persona”, për shumën 692,613 lekë e vendosur ekstra kontabël në bilanc gabimisht, pasi nuk ka debitorë.

- për mos kontabilizim të faturave të ujit, energjisë, postare e telefonike etj, por detyrimet ndaj të tretëve janë pasqyruar si teprica në bilancet përkatëse në mënyrë ekstra kontabël.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, neni 3, pika 1 dhe VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, pjesa e parë “Rregulla të përgjithshme”, kapitulli i parë, “Mbajtja e kontabilitetit”, me Udhëzimit Ministrisë Financave nr. 26, datë 27.12.2007 “Për disa shtesa e ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë Financave nr. 14, datë 28.12.2006, “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njësitë që varen prej tyre”, i ndryshuar si dhe me nenin 9, “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues” e Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, kreu III-të, “Regjistri aktiveve, dokumentimi i lëvizjes tyre”, pika 36, 37 e 38.

“Vërejtje”, për:

4. A.D. me detyrë inspektor i taksave vendore,

5. A.B. me detyrë inspektor i taksave vendore,

për shkeljet e mëposhtme:

-për të meta dhe mangësi në mbajtjen e dosjeve të subjekteve, pasi ato nuk janë të kompletuara me dokumentacionin e duhur.

-për punë të dobët në vjeljen e debitorëve me vlerën 10 milion lekë ndaj 150 subjekteve fizike e juridike dhe për mos rregjistrimin dhe disiplinimin e 31 subjekteve të paregjistruara, që ushtrojnë aktivitet privat dhe nuk shlyejnë detyrimet e taksave lokale.

-për mos aplikim sanksionesh ndaj subjekteve të biznesit vogël, të cilat nuk kanë paguar në afat detyrimet tatimore, për vitin 2012 dhe 2013.

-për mungesë kontrolli në vend për xhiron e subjekteve dhe mos shfrytëzimin e të dhënave dhe mos rivlersim shtese te taksave.

-për mungesë bashkëpunimi me drejtorinë e Urbanistikës dhe Shërbimeve.

-për 2,400 mijë lekë mungesë të ardhurash të konstatuara dhe për mos realizim të planit të ardhurave nga taksat vendore në masën 60 % për vitin 2012, 2013 dhe 9-mujorin 2014.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 ndryshuar me ligjin nr. 9745, datë 28.05.2007 “Për sistemin e taksave vendore”, me udhëzimin e Ministrisë Financave dhe Ministrisë Brendshme nr. 655/1, datë 06.02.2007, si dhe me nenin 42 të Rregullores së brendshme të Bashkisë.

“Mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në 6 muaj”, për:

6. L.N. me detyrë veteriner, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos administrimin e tarifës së therjes bagëtime, pasi për vjeljen e saj nuk janë përdorur biletat, por janë përdorur mandatarkëtime, të cilat nuk janë të sekretuara me vulë të Bashkisë dhe në plotësimin e tyre ka parregullsi, veprime në kundërshtim me kërkesat e udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin aktiveve në njësitë sektorit publik”,

-për mos vendosje gjobe për kundravajtjet në asnjë rast për vitin 2012 dhe 2013.

-për mosrealizime të tarifës therjes bagëtime, e cila paraqitet në nivele të papërfillshme prej 50 mijë lekë për çdo vit.

7. F.Q. me detyrë inspektor i INUV, për shkeljet e mëposhtme:

-për mos vendosjen e asnjë gjobe, mos prishjen e 32 ndertimeve dhe mos bërjen e asnjë kallximi penal për ndërtimet e paligjshme, në kundërshtim me nenin 5/b e d, 13 dhe 14 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, me ligjin nr. 10240, datë 25.02.2010 dhe nr. 10323, datë 23.9.2010, me nenin 75, 77, 81 “Sanksionet” të ligjit “Për Urbanistikën” i ndryshuar dhe pikën 8 të VKM nr. 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të teritorit nga inspektoriati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai Vendor”,

-për mos bashkëpunim me strukturat policore, për prishjen dhe lirimin e hapsirave publike nga ndërtimet e paligjshme, shembjen e mureve, shkallëve në trotuare, prishjen e kioskave dhe shtesave pa leje, lirimin e oborrit brenda dhe jashtë muzeut Kombëtar “Skenderbeu” etj, pamvartesisht se shumica eketyre ndertimeve u perkasin viteve para periudhes se auditimit, veprime në kundërshtim me kërkesat e nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar,

-për mos inventarizimin dhe arshivimin e dosjeve të Inspektoriatit ndërtimor Urbanistik, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.

II. Mbështetur në nenin 59 “llojet e masave disiplinore”, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, në nenin 72 “Kundravajtjet administrative” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, **lihet në kompetencën e kryetarit të Bashkisë Krujë, dhënia e masave disiplinore dhe administrative,** (vërejtje me paralajmërim), **për njësinë e hartimit të dokumenteve të tenderit,** për punonjësit:

1. *E.S.me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Juridik, në cilësinë e njësisë së hartimit të Dokumenteve të tenderit,*

2. *Xh.R. me detyrë inspektore e infrastrukturës publike, në cilësinë e njësisë së hartimit të Dokumenteve të tenderit,*

3. *B.M. me detyrë inspektor QKR, në cilësinë e njësisë së hartimit të Dokumenteve të tenderit,*

4. *M.N. me detyrë topograf, për shkeljet e mëposhtme:*

-për hartimin e projektit, preventivit, grafikut të punimeve dhe specifikimet teknike, në tenderin “Sistemim-gjelbërim i zonës së banimit në Derebe, Krujë”, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, “Për rregullat e prokurimit publik”, Kreu V, “Zhvillimi i procedurave”, nënpika 2, “Hartimi i dokumenteve të tenderit”.

-për hedhje të gabuar në sistem të preventivit të punimeve, në dy raste me marrjen e ankesave nga operatorët ekonomikë, nuk ka ndërprerë procedurën e prokurimit, vendosje në disa raste të kërkesave për kualifikim në kundërshtim me DST, vendosje në dy raste të paargumentuar të kritereve për kualifikim, në një rast tenderi me objekt: “Sistemimi i kapitazhit të ujësjellësit Sakarrac - Krujë” me “procedurë me negociim pa shpallje paraprake të botimit të kontratës”, nuk ka asnjë të dhënë mbi kërkesat e veçanta për kualifikim dhe kriteret e shpalljes së fituesit si dhe ftesat për ofertë nuk janë hartuar sipas kërkesës së LPP, për procedurën e tenderit me objekt: “Sistemim-gjelbërim i zonës së banimit në Derebe, Krujë” specifikimet teknike (preventivi), nuk janë analitikë, ato japin të dhëna në total. Në dy raste për përcaktimin e kritereve të veçanta për kapacitetin teknik, nuk ka asnjë të dhënë se si është përcaktuar numri i punonjësve që duhet për të kryer këtë punë, përcaktimi i makinerive, të cilat janë bërë pjesë e DT, në një rast nuk është respektuar me një ditë afati i publikimit nga data e hapjes së tenderit, të publikuar në faqen e internetit të APP-së, për rrjedhje të bllokimit të sistemit nga mosrespektimi i këtij afati. Në një rast nuk ka bërë të qartë modifikimin e dokumenteve të tenderit.

Nga Bashkia Krujë, me shkresë nr. 1424/5, prot, datë 19.01.2015, protokolluar në KLSH me nr.985/9 datë 21.01.2015, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Besim Bileri, Lolita Baholli, Nefail Xhepexhiu, Pal Daci dhe Enejda Seraj, më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT